

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Ekonomike, me gjyqtaren Franciska Zhitia-Ymeri, në çështjen juridike të paditëses ish-Zyra e Rregullatorit për Ujësjellës dhe Mbeturina (ZRRUM), me seli në Prishtinë, Rr. F.D, nr., tash Republika e Kosovës-Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU), të cilën me autorizim e përfaqëson M.C, kundër të të paditurës Kompania Regjionale e Mbeturinave “P” sh.a me seli në F, Rr. E.T, nr., të cilën me autorizim e përfaqëson avokati K.A, për pagesën e borxhit në shumën prej 43,146.79 euro, në shqyrtimin kryesor-publik të mbajtur në prani të autorizuarit të paditësit dhe të paditurës, të dt. 24.04.2017, ndërsa pas marrjes së fjalëve përfundimtare të palëve në procedurë me datën 15.05.2017, ka marrë këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit ish-Zyra e Rregullatorit për Ujësjellës dhe Mbeturina (ZRRUM), me seli në Prishtinë, tash Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU).

II.DETYROHET e paditura KRM “Pa” sh.a. me seli në F, që paditëses ish-Zyra e Rregullatorit për Ujësjellës dhe Mbeturina (ZRRUM), me seli në Prishtinë, tash Republika e Kosovës-Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU), t’ia paguaj emër të borxhit të mbetur për periudhën kohore prej datës 27.07.2009 deri me datën 30.06.2012, shumën e përgjithshme prej 28.382.83euro,(njëzet e tetë mijë e treqind e tetëdhjet e dy euro e tetëdhjet e tri cent) me kamatë ligjore të cilën e paguajnë bankat vendore si për mjetet e deponuara në kursim me afat mbi një vit e pa destinim të caktuar, duke filluar nga data e paraqitjes së padisë 20.07.2012, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afatin parativ prej 7 (shtatë) ditëve, duke llogaritur nga data e pranimit të këtij aktgjykimi.

III.REFUZOHET si e pabazuar pjesa e kërkesëpadisë në shumën prej 14,763.96 euro.

IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale veç e veç.

A r s y e t i m i

Paditësja me datë 20.07.2012, ka ushtruar në Gjykatë propozim për përmbarimin e borxhit në bazë të dokumentit të besueshëm (faturave), në shumë prej 49,405.18 euro.

Gjykata Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Ekonomike me Aktgjykimin VI.C.nr.125/2013, të datës 14.01.2014, kishte aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe e kishte detyruar të paditurën që në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore t’ia paguaj shumën prej 617.50 euro.

Kundër Aktgjykimit të Gjykata Themelore në Prishtinë –Departamenti për Çështje Ekonomike e paditura kishin ushtruar ankesë në bazë të të cilës Gjykata e Apelit e Kosovës me Aktvendimin Ae.nr.52/2014, dt. 27.10.2014, ankesën e paditurës e ka aprovuar ndërsa lëndën e ka kthyer në rigjykim.

Me parashtrësë me shkrim përfaqësuesja e paditëses ka bërë precizimin e padisë në aspektin subjektiv dhe atë Republika e Kosovës-Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit, po ashtu i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadia e paditësit të aprovohet në tërësi si e bazuar dhe të detyrohet e paditura që në emër të borxhit për periudhën kohore prej datës;01.01.2007 deri me datën; 30.06.2012, ti paguaj shumën prej 43,146.79 euro, ndërsa në emër të kamatës ligjore për vonesë nga data e rrjedhjes për pagesë të secilës faturë e deri me datë 09.12.2013 shumën prej 3,443.39 euro, në shumë të përgjithshme prej 46,590.00 euro, së bashku kamatën vjetore prej 3,5 %, mbi shumën e borxhit prej 43,146.79 euro, të llogaritur nga data 10.12.2013, e deri në pagesën definitive.

Duke iu referuar pohimeve në padi dhe deklarimeve të dhëna gjatë procesit gjyqësor, i autorizuari i paditëses ka theksuar se paditësja në cilësinë e Organit Mbikëqyrës Rregullator i ka licencuar të paditurën, ndërsa e paditura nuk i ka bërë pagesat e licencës sipas tarifës së përcaktuar, andaj për periudhën prej 01.01.2007 deri me 30.06.2012 i ka mbetur borxh shumën prej 43,146.79 euro. E paditura i ka pranuar faturat, por nuk e ka bërë pagesën e tyre, edhe pse paditësja vazhdimisht i ka kërkuar pagesën e faturave, i ka propozuar gjykatës që pas administrimit të provave, ta aprovoi kërkesëpadinë e paditësit në shumën e precizuar, së bashku me kamatën ligjore. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar por nuk i ka specifikuar

I autorizuari i të paditurës gjatë gjithë shqyrtim gjyqësor dhe në parashtrësat e tij ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditësit duke e kundërshtuar legjitimitetin aktiv të paditësit si dhe kompetencën lëndore të kësaj gjykate ndër të tjerash ka theksuar se kërkesëpadia e paditësit është parashkruar dhe mbi këtë bazë ka kërkuar që gjykata ta refuzojë në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar. Shpenzimet e procedurës.

Gjykata për të vendosur lidhur me këtë çështje juridike ka administruar këto prova, si në vijim duke filluar nga: Procesverbali mbi aktvendimin e procedimit të provave e dt. 14.01.2014, lexohet vendimi me nr. 3/12 e dt. 05.02.2015, qarkullimi prej 01.01.2003deri me 31.12.2015, dt. 01.01.2003 deri me 31.12.2008, përcjellja e udhëzimit administrativ e dt. 10.10.2009, paralajmërimi i dt. 21.06.2011, i dt. 11.06.2011 deri me 03.02.2009, prill 2008, 17.04.2008, me 2 shtojca, njoftimi i dt. 21.03.2011 kërkesë e dt. 24.06.2011, ndërprerja e pezullimit të licencave, në administrimin e mbeturinave komunale për operatorët privat, dt. 15.korrkk 2011, procesverbali nga takimi ZRUM, dhe përfaqësuesve të KRM dhe KMD 19 JANAR 2012, 02.11.2011, raporti i vizitave pa datë, shkresë e d.t 11.08.2011, MMPH, aktvendimi me nr. E. nr. 498/2012, e gjykatës ekonomike në Prishtinë e dt. 16.08.2012, kërkesë për dhënien e sqarimit sa i përket legjitimitetit pasiv të KRM-së sipas ligjit në fuqi e muajit tetor 2015, vendimi lidhur me përdorimin e vulës dhe logos së re e dt. 26.09.2012, kërkesë e dt. 19.09.2012, procesverbali për ndryshimin e vulave zyrtare të ZRUM e dt. 24.09.2012, kërkesë 18.09.2012. kërkesë e dt. 25.09.2012, përgjigje e dt. 24.11.2015, e dt. 24.11.2015, përgjigje në kërkesë nga MMPH me nr. A 329/15, e dt. 24.11.2015, njoftimi i dt. 01.02.2017, kërkesa për lirim e shlyerjeve nga taksa e ZRMU, udhëzimi administrativ e dt. 20.12.2006, 06,04,2011,

06.01.2011, 24.11.2008, 06.01.2010, 06.04.2011, 06.01.2012, njoftim e dt. 24.05.2012, 24.05.2016, 24.05.2016, njoftimi i drejtuar komisionit për buxhet dhe financa, Ministrisë së administratës publike kryetarit të kuvendit të Kosovës kryetarit të komisionit BZHRH, Ministrisë së ambientit dhe planifikimit hapësinor ministrisë së zhvillimit ekonomik ministrisë së bujqësisë, Ministrisë së pushtetit lokal, Ministria e punës dhe mirëqenie sociale Asociacioni komunave drejtori i buxhetit të Kosovës MTT, kërkesa për buxhet shtesë e dt. 24.05.2016.

Deklarimet e të autorizuarit të paditësit, deklaramet e përfaqësuesit të paditurës, referimeve të Gjykatës së Apeli, si dhe provat e prezantuara dhe të administruara, gjykata i vlerësoi të gjitha, një nga një dhe në varësi me njëra tjetrën, në vështrim të nenit 8, të Ligjit mbi procedurën konstestimore (LPK) dhe gjeti se:

Nga mendimi dhe konstatimi i ekspertit financiar A.K e dhënë në ekspertizën e datës 09.12.2013, ka vërtetuar se e paditura nuk i ka përmbushur në tërësi obligimet në emër të licencës së veprimtarisë ndaj paditësit siç ka qenë e parashikuar me ligjet në fuqi të Republikës së Kosovës për periudhën janar 2007 deri me datën 30.06.2012, që është objekt i kësaj kontrate dhe në bazë të provave të cilat gjinden në shkresa të lëndës konstatohet se vlera e përgjithshme e obligimeve të mbetura të të paditurës është 43.146,79 euro.

Gjykata nga faturat e administruara gjeti se kërkesëpadia e paditësi është pjesërisht e parashkruar për shkak se nga fatura e datës;04.06.2007 deri në me datën;26.06.2009 të cilat përfshin shumën prej 14.763,96 euro, e deri te paraqitja e padisë e datës 20.07.2012, kanë kaluar më shumë se 3 vite, andaj duke iu referuar dispozitës së nenit 374 të LMD-së, gjykata ka konstatuar se kërkesëpadia e paditësit për këtë shumë është e parashkruar,ndërsa për periudhën kohore nga data 27.07.2009 e deri me datën 30.06.2012, kërkesat e paditësit nuk janë të parashkruara dhe se të njëjtat arrin shumën e përgjithshme prej 28,382.83 euro, duke u bazuar edhe në ekspertizën financiare e punuar nga eksperti A.K, andaj dhe ka vendosur si në pikën një të dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimin e të paditurës se paditësi nuk ka legjitimitet aktiv, por një pretendim i tillë është refuzuar si i pa bazuar për shkak se paditësi ka ofruar provë me të cilën ka provuar me njoftimin e datë 24.05.2016, se me rastin e ndryshimit të ligjit të ri nr.05/L-042 ka ndryshuar emërtimin ku tani e tutje quhet Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU), andaj edhe legjitimiteti aktiv i palës paditëse është vërtetuar përmes kontinutetit të saj që nga ZRRUM, në ZRRUK dhe në fund në ARRU, po ashtu gjykata ka vlerësuar edhe pretendimin tjetër të paditurit lidhur me kompetencën lëndore të kësaj gjykate edhe këtë pretendim gjykata e ka refuzuar si të pa bazuar për shkak se me aktvendimin e Gjykatës së Apelit nr Ae.140/2016 dt.23.12.2016, ka caktuar kompetencën e kësaj gjykate .

E paditura, duke mos e kryer detyrimin e saj, rezulton se i ka mbetur borxh paditëses për pagesën e tarifës së licencës sipas faturave të pranuar, andaj ndërmjet palëve ndërgjyqëse është krijuar raporti detyrimor, në të cilin paditësi e ka cilësinë e kreditorit ndërsa e paditura cilësinë e debitorit, andaj sipas nenit 262 të LMD-së, kreditori në marrëdhëniet detyrimore ka të drejtë që nga debitori të kërkojë përmbushjen e detyrimit, si dhe shpërblimin e dëmit që ka pësuar për shkak të mos përmbushjes së detyrimit apo vonesës në përmbushje, ndërsa debitori ka për detyrë përmbushjen e detyrimit në tërësi, prandaj gjykata duke u nisur nga fakti se e paditura me

mospagimin e faturave i ka mbetur borxh paditësit, me aplikimin e dispozitës së lartë cekur dhe në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, vendosi që ta detyroj të paditurën që paditësit t'ia kompensoj borxhin së bashku me kamatën ligjore, në shumat e gjykuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Meqenëse i padituri, ka rënë në vonesë lidhur me pagesën e borxhit të krijuar, duke u bazuar në nenin 277 të LMD-së, lartësia e kamatës në rastin konkret, i referohet shkallës së kamatës, të cilën e paguajnë bankat afariste në Republikën e Kosovës, për mjetet e deponuara pa destinim dhe për periudhën kohore të deponimit, me shumë se për një vit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të nenit 450 të LPK-së, që secila palë ti bartë shpenzimet e veta procedurale veç e veç, ndërsa shpenzimet e procedurës kontestimore të palës paditëse janë refuzuar për faktin se të njëjtat nuk janë specifikuar, andaj bazuar në nenin 463 paragrafi 2 të LPK-së.

Prandaj, bazuar me nenin 262, 374 dhe 277 të LMD-së, si dhe në nenin 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Çështje Ekonomike
III.Ek.nr.625/16 me datën 15.05.2017

Gjyqtarja
Franciska Zhitia Ymeri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta e ankesës në afatin kohor prej 7 (shtatë) ditëve, nga dita e pranimin të të njëjtit, duke iu drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.